

VENDIM
Nr.262, datë 3.10.2011

MBI MOSRINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR POLIÇANI”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira	Bushati	kryetare
Sami	Nezaj	zëvendëskryetar
Suela	Musta	anëtare
Alban	Karapici	anëtar
Gent	Ibrahimi	anëtar
Zylyftar	Bregu	anëtar,

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi mosrinovimin e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “TV kabllor Poliçani”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 25 dhe neni 33 pikat 1 dhe 5 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr.171, datë 31.5.2011, i KKRT-së,

VËREN SE:

Me vendimin nr.171, datë 31.5.2011, KKRT-ja, ka vendosur mosrinovimin paraprak të licencës për subjektin televiziv privat kabllor “TV Kabllor Poliçani”, për arsye se:

Subjekti kishte paraqitur ekstraktin historik të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit jashtë afatit 1-mujor; Sanksionet me gjobë nr.334, datë 12.1.2011 në vlerën 400.000 lekë dhe nr.363, datë 3.3.2011 në vlerën 800.000 lekë, nuk ishin shlyer nga subjekti; Subjekti nuk kishte paraqitur grilën e strukturës programore, si dhe programin ditor e javor, kontratat e punës dhe pagesën për kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhën e mëparshme të licencimit, skemën principale të vijueshmërisë së sinjalit deri tek abonenti, bllok-skemat e amplifikatorëve të funksionimit të magjistratit kryesor dhe të degëzimit të parë dhe të dytë.

Bazuar në pikën 2 të këtij vendimi, subjekti kishte të drejtë që brenda 30-ditësh të parashtronte plotësimet e mangësive të konstatuara. Edhe pse ky afat ka kaluar, rezulton se deri më tani, subjekti nuk i ka depozituar mangësitë e konstatuara në dokumentacionin për rinovimin e licencës. Licenca për këtë subjekt ka përfunduar më datë 12.11.2010.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 25 dhe nenit 33 pikat 1 dhe 5 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr.171, datë 31.5.2011, i KKRT-së,

VENDOSI:

1. Të mos rinovojë licencën për operatorin televiziv privat kabllor “TV kabllor Poliçani”.
2. Licenca me nr.027/RTV kabllor bëhet e pavlefshme.
3. Subjekti të ndërpresë menjëherë transmetimin, pasi në të kundërt do të përballlet me sanksionet përkatëse, nga sanksioni me gjobë deri në sekuestrimin e pajisjeve transmetuese.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
5. Ngarkohet administrata e KKRT-së për veprime të mëtejshme sipas ligjit.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati